



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr/ 005/2011
Data: 01/02/2011

Në bazë të nenit 40 dhe nenit 5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, neni 3 i Statutit të Komunës, propozim vendimi me numër 02/Nr/02/2011, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 27.01.2011 merr këtë:

VENDIM

PËR

FORMIMIN E KOMISIONIT PËR PËRGADITJEN E MATERIALIT PËR PADI KUNDËR SERBISË

I

Kuvendi i Komunës miratoi propozim vendimin me numër 02/Nr/02/2011 të datës 10.01.2011 për formimin e një komisioni për grumbullimin e të dhënave dhe ngritjen e padisë kundër Serbisë për krimet e kryera në territorin e Komunës së Hanit të Elezit.

II

Komisionin do ta formoj Kryetari i Komunës dhe ai komision do t'i grumbullon të gjithë materialin, faktet, argumentet, për përgatitjen e padis kundër Serbisë.

III

I gjithë materiali i grumbulluar nga ana e komisionit sipas nenit II do t'i kthehet në miratim Asambleja së Komunës dhe sipas këtij materiali do të bëhet përgatitja e padis kundër Serbisë

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.

V

Me këtë vendim njoftohen: Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Menduh Vlashi

